



2013

RAPORT- TM₃ -2013




K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hr-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	3
I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	4
1.1 Aktivitetet – Korrik-Shtator 2013	4
1.2 Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	6
1.3 Planifikimi I investimeve emergjente	6
1.4 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	7
1.5 Zyra për planifikim dhe zhvillim	7
1.6 Servisimi I ujëmatësave	9
1.7 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	10
II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	12
2.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	12
2.2 Pengesat në realizimin e objektivave	14
2.3 Planet për të ardhmen	14
2.4 Aktivitetet e shërbimit për informim	16
III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	17
3.1 Aktivitetet - Korrik- Shtator 2013	17
3.2 Personeli	19
3.3 Raport I zyrës ligjore	20
3.4 Aktivitetet e zyrës së Teknologjisë Informativë	25
IV. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	27
4.1 Aktivitetet - Korrik-Shtator 2013	27
4.2 Raport I performances financiare- TM ₂ -TM ₃ - 2013	29
V. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM	36
Shtesa I: Raporti I investimeve	

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



I. SHËRBIMI TEKNIK

1.1 Aktivitetet – Korrik-Shtator 2013

Furnizimi

Edhe pse prurjet e ujit ne burimet e vjetra me gravitet kane filluar te ken rritje por jo ne mas te duhur, fale shtimit te kapaciteteve te reja te ujit te pijes tek lokacioni „40 Burimet“ kemi arritur te kemi gjendje stabile te furnizimit me uje per te gjithë qytetin e Prizrenit me regjion e sidomos për konsumatorët që furnizohen me sistem te gravitetit.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur qe ne muajin Shtator te vitit 2013 te furnizojë të gjithë konsumatorët me uje te pijes 24 ore ne perjashtim te zonave te larta te cilat furnizohen me sistem te pompimit ku dhe kemi reduktime te shkurtëra brenda dites (Kryesisht Laxha Dardania). Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pasë probleme me furnizim me uje te pijes dhe duke u bazuar ne raportet e Njesive Operuese kemi patur furnizim pa nderprerje me uje te pijes.

Uji i prodhuar

Për muajin Korrik-Gusht - Shtator te TM-3 vitit 2013 ne nivel regjional janë raportuar prodhim te ujit. 5,455,972 m3 krahasuar me TM-2 kemi nje rritje te prodhimit te ujit te pijes prej 594,567m3. Jane duke vazhduar aktivitetet në sigurimin e burimeve te reja te ujit te pijes, ne kaptimin e ketyre sasive te reja si dhe injektimin e kesaj sasie ne rrjetin distributiv.

Uji i pa faturuar

UPF vazhdon te mbetet nje sfide kryesore e te gjitha sherbimeve te kompanise, ku ne bashkpunim me te gjitha sherbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve te huaj dhe instutacioneve vendore kemi planifikuar shume aktivitete kryesisht ne zvogelimin e UPF-se.

Kompania ne nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore per zvogelimin e UPF-se qe nenkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohe te defekteve ne teresi.

Shërbimi Teknik me te gjithë sektoret e tije është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u perpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania eshte duke i vazhduar aktivitetet per zvogelimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Eshte formuar grupi i veçant brenda Depertamentit Teknik per verifikimin e rrjetit shperndares dhe verifikimin e valvulave ne qytetin e Prizrenit. Deri me tani eshte verifikuar rrjeti shperndares si dhe janë duke i berë analizat neper zonat e furnizimit.

Raportet tregojne qe UPF ne nivel regjional per TM-3 eshte 59.18 %ose 0.79% me pakë humbje nga TM-2

Faturimi ne nivel regjional per TM-3 eshte prej 2,220,896.00 m3 me nje rritje te faturimit prej 281,201 m3 krahasuar nga TM-2.

Aktivitetet e shërbimit Teknik në nivel regjional kanë qenë të parreshtura dhe janë orientuar në mundësinë e furnizimit sa më të rregullt me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët që kjo kompani i mbulon, si dhe në aktivitetet teknike për uljen e humbjeve si atyre teknike poashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave të UPF-se.

* Në këto TM-3 janë bërë hapja e pesë puseve tek 40 burimet më thellësi përafësisht nga 50 metra si dhe janë kryer punimet për hapjen e galerisë duke krijuar lidhjet e puseve me një sistem të përcjellës në gjypin kryesor me qëllim për të furnizuar me ujë tërë qytetin e Prizrenit, dhe këto puse sjellin një sasi të ujit afërsisht 110 l/s, kështu që kjo galeri mundson rrjedhje të ujit më lirë si dhe sipas nevojës edhe me sistemin e pompave.

* Nga Departamenti Teknik janë plotësuar dokumentacionet e nevojshme për Pelqimet-Lejet përkatëse të cilat janë dërguar në MMPH dhe në Komunën e Prizrenit për projektin Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujërave të Zeza. Pasi që lidhur me lejet përkatëse për ndërtimin e ITUZ-se, janë dy institucionet përgjegjëse:

- ✚ Ministria përgjegjëse për çështjet mjedisore që lejon projektimin, sistemin dhe shkallën e procesit të trajtimit, dhe
- ✚ Komuna e Prizrenit e cila për rehabilitimin dhe ndërtimin e dy kolektoreve si dhe ndërtimin e ITUZ-se do të jap lejen përkatëse.

* Nga komuna e Prizrenit jemi në procedurë të rregullimit të dokumentacionit përkatës, ku në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është leshuar një pelqim për mundësinë e manovrimeve teknike të cilat kanë të bëjnë me projektin, kurse nga Drejtoria e Urbanizimit janë leshuar kushtet urbanistike të cilat duhet të plotësohen dhe është marrë leja e influentit për ujra të zeza.

* Në takim me menaxhmentin e „Hidroregjionit“ jemi dakorduar për shkak të keqperdorimit të ujit të pijes nga disa konsumator, lagje ose fshatë të mos ketë furnizimi të rregullt me ujë të pijes aty ku humbjet janë të mëdha në baze të matjeve nga ujëmatësit zonal, këto zona do të aplikohen në të gjithë regjionin e Prizrenit.

* Kohë më parë është nënshkruar Marrëveshja me përfaqësuesit e fsh. Kabashë, HRJ si dhe nga Kryetari i Komunes së Prizrenit. Nga kjo marrëveshjeje sistemi i ujit të pijes kalonë nën menaxhimin e Hidroregjionit jugor, ku ekipet tona e kanë verifikuar gjendjen e ujësjesit dhe të kanalizimeve në fshatë si dhe kanë bërë instalimin dhe bllokimin e ujëmatësive të të gjitha konsumatorve.

* Në këto TM-3 me kërkesën e firmës NPT „ART-COM“ për hulumtimin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit i lejohet firmës „art-com“ të bëjë kyqjen e aparaturave në gjypat e ujit për të hulumtuar prodhimin e energjisë elektrike dhe pas hulumtimit do të paraqet firmë një raport të gjendjes reale për prodhim të energjisë elektrike, deri më tani nuk është bërë një hulumtim i tillë.

* Në TM-3 janë bërë vazhdimi i shpimeve të puseve në fsh. Sallagrazhd për qytetaret e komunes së Suharekës dhe jemi në vazhdim të shpimeve të puseve tjera me qëllim që furnizim me ujë të jetë i mjaftueshëm për Suharekën dhe fshatrat për rrethë

* Kohë më parë është nënshkruar Marrëveshja me përfaqësuesit e fsh. Kabashë, HRJ si dhe nga Kryetari i Komunes së Prizrenit. Nga kjo marrëveshjeje sistemi i ujit të pijes kalonë nën menaxhimin e Hidroregjionit jugor, ku ekipet tona e kanë verifikuar gjendjen e ujësjesit dhe të kanalizimeve në fshatë si dhe kanë bërë instalimin dhe bllokimin e ujëmatësive të të gjitha konsumatorve.

* Sa i perket Projektit Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave te Zeza tani me jemi ne fazen e perpilimit te konceptit kryesore ne lidhje me Fillimin e projektit Detal, Kompania P2M dhe ajo Vendore Alb-Architect jane vendosur ne Objektet e HRJ-se dhe ne bashkpunim me Stafin Teknik te HRJ-se jane duke u grumbulluar informacione teknike dhe administrative te cilat do te ndikojne ne mbarevajtjen e projektit. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

* Jane pergaditur komplet dokumentacionet per aplikmin e lejes Ujore pran MMPH, me çrast dhe jane dorezuar Aplikacionet ne Depertamantin e Ujerave, presim pergjegje nga Departamenti perkates. Edhe ne muajin Gusht te vitit 2013 nuk eshte leshuar Leja Ujore nga Departamenti i Ujerave prane MMPH ne Prishtine gjate keti muaji jemi paisur me leje nga MMPH per hulumtime te ujit.

* Eshte berë hulumtimin e ujit te pijes ne kete TM-3 per komunen e Malisheves me shpimin e puseve ne fsh.Senik me prodhim afërsishtë mbi 30 l/s si po vazhdohet per hapjen e puseve tjera me qellim per te furnizuar edhe fshatrat per rrethe te Malisheves.

* Ne kete TM-3 kemi patur takimet me Kryetarin e Dragashit si dhe jemi dakorduar te behet pregaditja per nenshkrimin e marrveshtjes per fsh.Brezne qe te kalohet nen menagjimin e Hidroregjionit, andaj ekipet tona kan verifikuar gjendjen reale te ujesjellesit dhe pritet se shpejti te behet nenshkrimi i marreveshtjes.

* Departmenti teknik ka bërë të gjitha pregaditjet për të zgjidhur problemin e ujit të pijes për qytetin e Prizrenit dhe ka bërë projekte ideore dhe shumen e perafert , me qellim qe keto projekte ideore ti prezentohen ne nje te ardhem asambles komunale ne Prizren.

* Në keto tre mujor TM-3 janë bërë leximet e ujmatsëve zonal per qdo muaj me qellim per te verifikuar hargjimet e ujit neper zonat e veqanta.

1.2 Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e te gjithë konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithë konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

1.3 Planifikimi I investimeve emergjente të kompanisë për përmiruar situaten e furnizimit me ujë të pijës

* * Implementimi i pjeses se pare dhe te dyte te Fazes se Dyte te projektit kryesor „40 Burimet“ i cili parasheh:

* Ndertimin e Komores ujembledhese dhe injektimin e sasise se re te ujit te pijes ne rrjetin distributiv te qytetit te Prizrenit. Eshte perpiluar projekti ideor i ndertimit te galerise percjellese dhe ndertimi i komores kryesorei cili per tu realizuar arrin vleren e perafert prej rreth 180,000.00 Euro, dhe hulumtimi dhe kaptimi i burimeve ekzistuese ne afersi te kaptazhes se IV-te i cili kap vleren prej 220,000.00 Euro.

* Vendosjen e linjes se veçante nga Marashi deri tek ETC-ja qe parashe ndarjen e zonave te furnizimit. Ndarjen e furnizimit te fshatrave dhe laxhes Bajram Curri nga rrjeti furnizues i qytetit, nga departamenti teknik eshte hartuar projekti i cili kap vleren e perafert prej 196,000.00 Euro.

* Kompania HIDROREGJIONI JUGOR ne Planin e Biznesit dhe ne Strategjine Zhvillimore ka planifikuar edhe planin afatgjate te investimeve per ujesjelles dhe kanalizim.

* Ne bashkpunim me K. e Prizrenit kemi hartuar planin investiv per uje dhe kanalizim ne te cilin kemi paraqitur planin dhe dinamiken e perfundimit te ketyre punimeve me te cilat planifikojme te zgjidhim perfundimisht furnizimin 24 oresh me uje te pijes per te gjithë konsumatorët e regjionit te Prizrenit ku kjo kompani i mbulon. *(Ekziston Plani investiv i Kompanise i cili duhet te revidohet ne fillim te vitit ose ne gjashtë e pare te vitit 2013.)*

* Zgjerimi i veprimtrise se Kompanise per marrjen e sistemeve Rurale nen menaxhimin e HRJ-se.

Kompania ka perpiluar hartat me mbulueshmeri te cilat i bashkangjiten ketije raporti. Menaxheri Teknik ka perpiluar planin e investimeve per vitin 2013, 2014 dhe 2015 si dhe njeherit eshte bere revidimi i plan biznesit per periudhen e dyte te vitit 2013.

Prodhim i ujit m³ –TM-3, 2013

TM-3	Prodhim TM-3 m ³	Prodhim ditor- m ³	Prodhim (l/sec)	Komente
Prizren	4,480,398.00	48,699.98	563.7	
Suharekë	481,206.00	5,230.50	60.5	
Dragash	131,812.00	1,432.74	16.6	
Malishevë	362,556.00	3,940.83	45.6	
Total	5,455,972.00	59,304.04	686.4	

1.4 Mirembajtja e rrjetit– Sanimi i defekteve TM-3, 2013

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	324	98	422
Suharekë	92	15	107
Dragash	02	0	2
Malishevë	41	11	52
Total	459	124	583

1.5 Zyra për planifikim dhe zhvillim – Korrik,Gusht,Shtator- TM-3

Për periudhen qe po raportojme ne kuader te zyres se Plan Zhvillimit grupet e organizuara te cilat veprojne ne terren kanë vazhduar bllobimet nëper qytetin e Prizren'it për të kryer refreshimin këto kanë arritur keto rezultate.

*Ujematësa te bllobuar 462 Ujematësa.

*Kontrata te nënshkruar 462 Kontrata

*Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 456 konsumator , kjo mosqasje është përcjellë nga ekipa dhe here pas here janë vizituar deri sa kanë arritur të kenë qasje.

*Konsumatorët që ekipa konstaton që duhet të zëvendësohet ujëmatës janë 17 Konsumator.

*Konsumatorët të pa bllokuar për shkak kushteve teknike 3.

*Konsumatorët pa ujëmatës 35.

*Konsumator të përgjithshëm 25 .

*Nuk ka pasur rekorde treja për blockmapping .

*Instalim ujëmatësive 1.

*Bllokimi për herën e dytë 73.

*Aktivizimi i faturës 10.

Nr.	Prizren Total – Gjithësej	Korrik	Gusht	Shtator	Gjithësej
1	Bllokimi-Kontrata	168	141	153	462
2	Dera Mbyllyr(Herën e dytë)	130	128	198	456
3	Pa Regjistruar	3	10	12	25
4	Zëvendësime	7	4	6	17
5	Pa Ujëmatës	9	15	11	35
6	Rekorde treja për blockmapping	0	0	0	0
7	Instalim	1	0	0	1
8	Bllokimi për herën e dytë	21	33	19	73
9	Aktivizimi i faturës	0	0	10	10

Aktivitetet kryesore

* Gjatë katër muajve prej aktiviteteve kryesore janë se rrijeti ujësjellsit prej sistemit koordinativ Gaus Kryger është kthyer në Kosovë Ref. Janë importuar në programin e ArcGIS 10, 27 harta, prej tyre 16 janë me të dhëna kompletuara.

* Në zyrën e GIS-it është korrigjuar edhe institucionet që nuk kanë mundësi të u ndërlidhur me faturim. Por është rregulluar gabimi në database edhe është korrigjuar.

* Është përfunduar harta 7E12-20-12 me 336 rekorde edhe është e gatshme për të u transferuar në programin e ArcGis ‘

* Me GPS Leica CS09 janë bërë matjet në terren dhe është marrë kordinata të sakta të rezervuarit I pusnices, rezervuarit I KFOR-it dhe rezervuarit I komunes.

* Janë eksportuar të dhënat prej faturistave për muajt Gusht,Shtator edhe janë ndërlidhur me programin e ArcGis-it. Hartat e importuara gjithësej në programin e ArcGis-it janë 17 harta, rekorde të ndërlidhura me faturistat janë 23197.

* Në muajt Korrik,Gusht,Shtator,grupi i terrenit demontim – montimit me njësi në Prizren kanë arritur që gjithësej të demontojnë dhe montojnë 546 ujëmatës.

* Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellsit ka bërë gjithësej 135 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 92 defekte,Ekziston raporti i veçant.Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 7887 m.

* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për këta muaj,2 prej ujëmatësve kanë qenë në defekt,është bërë intervenimi dhe janë riparuar, ujëmatësi në fshatin Atmaxh nuk ka regjistruar në të gjithë muajin Gusht për arsye se është krijuar një bajpas në të njëjten pusët për furnizimin e fshatit,dy prej ujëmatësve zonal nuk ka pas mundësi të u lexu,pusetat me ujë.

* Gjatë katër muajve ka vazhduar montimi dhe kontrollimi i konsumatorëve pa ujëmatës si dhe të konsumatorëve me faturim paushall në Prizren.

* Ujëmatësia të montuar 72 cope prej tyre 22 me pages , si dhe 50 pa pages

**1.6 Shërbimi i mirëmbajtjes– servisimi i ujëmatesave: Φ (13 - 100) mm
KORRIK, GUSHT ,SHTATOR te TM-3, 2013**

Njësia Operative	Profili Φ mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	119	Një ujëmatës 3/4" për fsh. Poslisht. Një ekspertiz
	3/4"	321	
	1"	47	
	5/4"	0	
	6/4"	0	
	Gjithsejt:	487	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Malishevë	1/2"	8	
	3/4"	25	
	1"	2	
	Gjithsejt:	35	

Totali : 522

Shërbimi i dedektimit te rrjetit të ujësjellësit—TM-3

TM-3, Muajt Korrik-Gusht-Shtator te vitit 2013 ekipa e dedektimit kanë bere dedektimin e rrjetit te ujesjellesit ne pjeset e qytetit me nje gjatesi prej 7987 m. si dhe kanë realizuar dedektime ne baze te kerkesave te konsumatorve .

Gjatë dedektimit te rrjetit kan gjetur 36 rrjedhje te ujit ku kan njoftuar ekipet e operatives dhe jan sanuar defektet me kohe kurse ka pasur raste te lajmruar nga konsumatorët per rrjedhje te ujit por nuk kan gjetur rrjedhje te ujit.

Aktivitetet e tyre janë të shënuara si më poshtë:

- Pune efikase ditore në bazë të nevojave të kompanisë për operacione të Detektimit të ujit.
- Analizimin dhe Kontrollimin e kërkesave te konsumatorëve te ujit.
- Menaxhimin dhe raportimin për zhvillimin e aktivitete në të gjitha aktivitetet e lartshënuar.

Në kuadër të aktiviteteve të lartshënuara ju prezantojmë këto rezultate :

- * Gjatësia e rrjetit të detektuar – 7987.m
- * Prurjet e gjetura gjatë detektimit – 3.2 l/s
- * Kërkesa të shqyrtuara – 135
- * Defekte të gjetura – 85
- * Defekte te pa gjetur-44
- * Defektet e gjetur ne rrugen kryesor -7

1.7 Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për TM-3

Korrik - 2013-të

Shërbimi I përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- *Marrja e Mostrave në Malishevë – Senik, dhe dërgimi I tyre në ISHP,02.07.2013;
- *Marrja e mostrave në Dragash,05.07.2013,
- *Vizita në Lubizhdë të Hasit(pas ankesës së tyre se është turbulluar uji) dhe marrja e mostrës;
- *Në Mulli riparimi I kloraparateve për shkak të papastërtisë së klorit(bombola 1000 kg) ku ka ardhur deri te zaptimi total I kloraparateve,15.07.2013;
- *Për herë të dytë ka ardhur deri te zaptimi I kloraparateve në Mulli(kemi njoftuar furnizuesin për këtë problem) dhe riparimi i komutatorit(ndarësi),22.07.2013;
- *Eliminimi defektit në sistemin e klorifikimit në Suharekë-Pusi I Atit;
- *Eliminimi I rrjedhjes së klorit në bunarllëk I pasi ka ardhur deri te zaptimi I sistemit të furnizimit me klor gas(ndërimi I bombolës 150kg),26.07.2013;
- *Pastrimi gjeneral I objekteve të Filtrimit dhe Koagulimit(vizita e Gjermanëve);
- *Përcjellja e klori residual në mënyrë të vazhdueshme në pika të ndryshme të furnizimit;
- *Pas futjes së autoklavës në funksion të plotë në laborator kemi filluar të bëjmë analizat bakteriologjike në laboratorin tonë, prej dt.10.07.2013

Gusht - 2013-të

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit


- *Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në Qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë,Malishevë e Dragash).
- *Sanimi (largimi) I Kontenjerit prej 1- tonëshe i klorit dhe pastrimi i aparaturave të klorifikimit nga papastërtit e kontenjerit në fjalë dhe zavendësimi i tijë me kontenjer tjetër te „Mulliri I Vjetër”.
- *Takime me personat adekuat në I.SH.Publik në lidhje me Kalibrimin e aparaturave në Laborator,
- *Marja e mostrave në Qytet, Njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
- *Janë marrun gjithsejt 34 mostra në nivel regional për analiza Bakteriologjike dhe ato 32 prej tyre I përgjigjen standardeve të ujit të pijes e 2 mostra nuk I përgjigjen.
- *Janë marrun 38 mostra për analiza Fiziko-Kimike dhe që të gjitha I përgjigjen standardeve të ujit të pijes. Mostrat janë marrun si vijonë:
- *Marrja e mostrave Fiziko-Kimike në Prizren gjithsejt 21 mostra , 6 mostra në fshatra ,
- *Marrja e mostrave Bakteriologjike në Prizren,gjithsejt 16 mostra, 3 mostra në fshatra
- *Lokacionet se ku janë marrun mostrat në Prizren:
Kroje publike 12 mostra
Kroje në shkolla publike 7 mostra
Kroje në restorane 6 mostra
- Mostra janë marrun edhe në qendra tregtare ,shtëpi private(ata që kemi pas ankesa)si dhe në burime sin në,, 40-burime” ashtu edhe në,, bunar 1”,po edhe në burime në fshatra.
- Marja e mostrave në Malishevë (Drejtori,K.K.Malishevë,Banjë,Pompat),si ato Fiziko-Kimike dhe ato Bakteriologjike,
- *Marja e mostrave në Dragash(Koagulator,Filter,Kr.pub rrugës për Drateks,rest,,Palma”)
- *Marja e mostrave në Suharekë(Te,, Loni”, „Benaf”, mark.,„Beli”,Savrovë,)
- P.s. 2 mostrat të cilat janë marr me 02.08.2013 në (rest. Pallma dhe Sarajeva) e që nuk u përgjigjen standardeve të ujit të pijes janë përsëritur më 05.08.2013 dhe që të dyja pastaj u përgjigjeshi standardeve të ujit të pijes.(Riparimi I bombolës së klorit te „Mulliri I vjetër).
- *Analizat Fiziko-Kimike-Janë marrun 38 mostra dhe të gjitha I përgjigjen standardeve të ujit të pijes e vendet e marruna janë këto të lartëcekura.

Shtator - 2013-të

Mostrat e marruna nga I.SH.P.

KORRIK-SHTATOR- 2013

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.
KORRIK	114	114	109	5	0	45	1
GUSHT	101	101	97	4	0	44	0
SHTATOR	134	86	81	5	48	44	0
Total	349	301	287	14	48	133	1
% e Deshtimeve				4.7			2.1
% e Desht. Total							4.3

**II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË****2.1 Aktivitetet**

- Në fund të TM3 në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 38.489 fatura, prej tyre: 33.336 amvisëri , 4542 biznese dhe 611 institucione. Në tremujorin e tretë në krahasim me tremujorin paraprak kemi 700 fatura të lëshuara me tepër. Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyqje ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës dhe rezultat i pëlqimeve për kyqje në shërbim të ujësjellsit dhe kanalizimit. Gjatë këtij tremujori është marrë nën menaxhim edhe fshati Sallagrazhd në njësin e Suharekës. Sipas njësive kemi këtë rritje të konsumatorëve në krahasim me muajin paraprak : Prizren: +291 , Suharekë: +334, Malishevë: + 57, Dragash: +18.

- Gjatë muajit TM3 janë faturuar 2,226,891 m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.823.460m³, biznese: 156.337 m³ dhe institucione 247.094 m³ ujë. Nëse e krahasojmë me tremujorin paraprak kemi një ne faturim më të madh prej 278.202 m³, ndërsa nëse krahasohet me TM2 të vitit paraprak kemi një rritje në faturim për 27.839 m³. Rritja e sasia së ujit të faturuar vjen si rezultat i rritjes së konsumit të tri kategorit e konsumatorëve, kjo rritje vjen edhe si rezultat i përmirimit të furnizimit me ujë.
- Arsyetim:
 - Rritja e faturimit për TM3 është rezultat i rritjes së konsumit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake si dhe shtimit të numrit të konsumatorëve nga muaji në muaj .
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a., në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive.

**RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES - Prill-
Qershor 2013**

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	296	24	23	2382	47,843.88 €
2	Suharekë	455	59	53	687	4,250.00 €
3	Malishevë	41	41	22	506	2,783.59 €
4	Dragash	7	0	0	0	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	799	124	98	3575	54,877.47 €

**RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES -Korrik -
Shtator 2013**

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	339	19	18	2645	47,414.72 €
2	Suharekë	285	43	29	604	11,420.00 €
3	Malishevë	57	17	28	551	6,643.30 €
4	Dragash	5	1	1	51	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	686	80	76	3851	65,478.02

- Në nivel rajonal kemi pranë 627 ankesa të konsumatorëve prej tyre:
 1. 407 ankesa teknike- detektive, mungesë të ujit, rrjedhje të ujit
 2. 220 ankesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave, faturim i dyfishtë etj
- Vazhdim i aksionit për njoftime për shkyçje të konsumatorët që:
 - Nuk i janë përgjigjur pagesave në dy muajt e fundit sidomos konsumatorët institucional dhe ka fillu riprogramimi i borgjit.
 - Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe riprogramimit të borgjit. Janë ndërru terenet e inkasanteve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.
 - Kontrollë të konsumatorët rreth eliminimit të keqperdorimeve të ujit
- Pjesmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a.
- Vizita në njësit operative me udhëheqësit e njësiteve lidhur me rritjen e efikasitetit rreth rritjes së faturimit, inkasimit dhe kontrollës të konsumatorët.

2.2 Pengesat në realizimin e objektivave

- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :
 1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike
 2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese.
 3. Te konsumatorët insticional –planifikimet e vogla në buxhet të organizatave buxhetore si dhe alokimet buxhetore në periudha tremujore po e pamundësojnë pagesën rrjedhëse për çdo muaj të kësaj kategori.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për të paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktive) po ndikojnë në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

2.3 Planet në vazhdimësi

- Formimi i dy ekipeve për së bashku me operativen për shkyçjen e konsumatorve borgjlinj të mëtej mbi =400,00 E në muaj do të shkyqen 10-20 konsumator të cilët

nuk i përgjigjen pagesës, ky aktivitet do të zhvillohet me eskavator i cili do të aktivizohet 3 ditë brenda javës.

- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borgjëve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjëve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistemin të pagesave të fakturave
 - Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pagesë nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .
 - Marrja e masave ligjore sipas Zyres rregullative për shkyqjen e konsumatorve për mos pagesë.
 - Rritja e efikasitetit të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
 - Pardia e konsumatorve në gjykatë për mos pagesë.
 - Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjëve aty ku kanë vështirësi inkasantet.
 - Angazhim i ekipes së kontrollës për 3-4 ditë në muja nga njësia e Prizernit nga njëra njësi në tjetrën.
 - Njësia e Suharekës ka planifikuar që në marrjen e këtyre masave konkrete që në të ardhmen të arrijë përmisimin dhe rritjen e shkallës së inkasimit dhe të arrijë një shkallë mesatare mbi 70% me qka llogarisim që ta arrijm mbulimin e shpenzimeve operative.
-
- Në nivel rajonal kemi pranuar 535 ankesa të konsumatorëve prej tyre:
 3. 367 ankesa teknike- detektive, mungesë të ujit, rrjedhje të ujit
 4. 168 ankesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave, faturim i dyfishtë etj
 - Vazhdim i aksionit për njoftime për shkyqje të konsumatorët që:
 - Nuk janë përgjigjur pagesave në dy muajt e fundit sidomos konsumatorët institucional dhe ka filluar riprogramimi i borgjit.
 - Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe riprogramimit të borgjit. Janë ndërruar terrenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.

- Kontrollë të konsumatorët rreth eliminimit të keqperdorimeve të ujit
- Pjesmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a.
- Vizita në njësit operative me udheheqësit e njërive lidhur me rritjen e efikasitetit rreth rritjes së faturimit, inkasimit dhe kontrollës të konsumatorët.

2.4 RAPORTI PËR MEDIA

KORRIK 2013

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	TJERA
1	01.07.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI:KOMPANIA "HIDROREGJIONI JUGOR" I MERR NË MENAXHIM E MIRËMBAJTJE VETËM RRJETET E UJËSJELLËSVE ME KËRKESËN DHE PËLQIMIN E VET BANORËVE TË FSHATRAVE	
2	13.07.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: IMPIANTI QË DO TA MBROJË LUMËBARDHIN	
3	20.07.2013	TV-OPINION RADIO HELIX	NJOFTIM: DEFJEKT NË LAGJRN "BAJRAM CURRI"	
4	24.07.2013	KOHA DITORE	ARTIKULLI: BORXHET E "EKOREGJIONIT" NDAJ " HIDROREGJIONIT" I LËNË PA UJË KROJET E VARREZAVE	
5	13.07.2013	RADIO KOSOVA	PRONONCIM NË RADIO KOSOVA - MËNGJESI EKOLOGJIK	

GUSHT 2013

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	TJERA
1	01.08.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: LUMËBARDHIT DO T'I RIKTHEHET FRESKIA	
2	29.08.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM LIDHUR PËR MUNGESË TË UJIT NË REGJIONIN E HASIT, PËR SHKAK TË PROBLEMEVE ME ENERGJI ELEKTRIKE	
3	30.08.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: HASI MBETET PA UJË TË PIJES	

SHTATOR

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	TJERA
1	19.09.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM LIDHUR ME INJEKTIMINE E 77 l/s UJË ME RËNIE TË LIRË	
2	02.09.2013	KOHA DITORE	DËSHTON PREMTIMI I KRYEMINISTRIT THAQI PËR LUMBARDHIN	

III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

3.1 Aktivitetet

Departamenti i administrates gjatë këtij tremujori është marrur me përgaditjen e raportëve ditore , javore dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Pas përgaditjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe të komiteteve janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me konkluzionet apo raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Është Njoftuar referenti për klorifikim dhe dezinfektim të ujit për raportin e kërkuar nga komitetit për hulumtime dhe teknologji lidhur me akreditimin e laboratorit të kompanisë.
- Janë Njoftuar të gjithë udhëheqësit e njesive operative për kërkesen e komitetit për hulumtime dhe teknologji për studim të çdo fshati në menagjim, sa është prodhimi i ujit, faturimi, shpenzimet dhe furnizimi me uji është me pompa apo me garvitet në menyrë që të dihet se ku është performanca pozitive apo negative dhe të lokalizohet problemi.
- Është Njoftuar shefi i ekipes se detektimit që KHT ka kërkuar të përgaditet raport detal sa l/s janë zbuluar si humje teknike të gjetura gjatë detektimit të rrjetit për periudhën janar-shtator 2013.
- Është Njoftuar udhëheqësi e njesis së Suharekës për kërkesen e Komisionit të Auditimit që të japin informatë për mos realizim të objektivave nga njesia.
- Është Njoftuar Menagjeri Rajonal për konsumator për arsyeshmerin shtesë të kërkuar nga Komisioni i Auditimit lidhur me realizimin e emisionit televiziv.
- Është Njoftuar Zyra e Prokurimit për kërkesen e Komisionit të Auditimit që zyra e Prokurimit për qdo shpallje tenderi dokumentet e kompletuara paraprakisht të paraqiten në Komision të Auditimit pastaj të bëhet shpallja.
- Janë vazhduar kontratat e punës që kanë qenë më kohëzgjatje prej tre(3) dhe gjashtë (6) muajve ngase kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar ne raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.

- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 11 (njëmbëdhjetë) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë. Pas mbylljes së konkursit perkatës më vendim është caktuar komisioni i cili shqyrton aplikacionet e aplikantëve, përgadit listen e ngusht të kandidatëve, kryen testin me shkrim dhe intervisten si dhe bënë zgjedhjen e kandidatit.
- Është bërë ndryshimi i koficientit të disa punonjësve pas kërkesës me shkrim nga udhëheqësit e tyre dhe aprovimit nga Zyrtari Kryesor financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimin apo pelqimin nga udhëheqësit e tyre.
- Për shkelje të lehtë të detyrave të punës janë shqiptuar 9 (nëntë) Vërejtje me shkrim për disa punonjës të Kompanisë në njësinë e Prizrenit, Suharekës dhe Malishevës.
- Në Kompani kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit perkatës.
- Kemi pasur vizit nga Inspektorati I Punës lidhur me rastin e vdekjes së punëtorit Imet Skenderi në vend të punës.
- Është përgaditur Vendim me të cilin përcaktohet komisioni që do të bëjë verifikimin e punës së kartelave të konsumatorët, kontrollimin e punës së shërbimit të financave, kontrollimin dhe verifikimin e punës së ekipeve të kontrollës dhe kontrollon vertetësinë e shërbimit të konsumatorëve nga rrjeti i ujës-jellës apo pusët individuale. Ky komision do të bëjë monitorimin e punës në njesinë e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
- Është përgaditur vendimi me të cilin përcaktohet komisioni që do të bëjë verifikimin e të gjitha hyrjeve , daljeve dhe gjendjen e stoqeve në deponë e njesisë së Suharekës.
- Janë përgaditur Vendimeve për mbikqyrje të punimeve dhe pranim teknik te punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave te njesive punuese.
- Me Vendim janë caktuar komisionet nga të gjitha shërbimet e Kompanisë lidhur me planifikimin dhe përgaditjen e plan-biznesit 2014-2016.
- Është përgaditur dhe dërguar modeli i përpilimit të raportit dhe planit javor të punës për të gjitha shërbimet e Kompanisë.
- Përgaditja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit perkatës.
- Përgaditja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompenzimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Përgaditja e kërkeses drejtuar Distriktit të KEDS-it në Prizren që të bëjë furnizim të rregullt me energji elektrike në të gjitha pikat e furnizimit ku qytetarët furnizohen me uji të pijes përmes sistemit të pompave.
- Nga Shërbimi Sprovues në Prizren kemi pranuar rehabilitimin e një të mituri me punë në mirëmbajtje të objektit të Kompanisë. (I mituri është Kastriot Gashi).
- Me aprovim të Kryeshefit Ekzekutiv është mbeshtetur Doku-festi në Prizren, të cilëve ju është lejuar për të pasur qasje në rrymen elektrike të Kompanisë.
- Në NJPMNP pas kërkesës së tyre janë dërguar të dhënat financiare dhe pozita e punës për ish punëtorin e Kompanisë Sabit Bytyqi-i caktuar në 2009 anëtar Bordi nga Qeveria e republikës së Kosovës.

- Është njoftuar NJPMNP për kohën e mungeses në punë të KE(pushim vjetor)dhe për zyrtarin që do ta zëvendësoj(Zv.KE-16.07-27.07.2013).
- Përgjigje NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike nga asnjë profil i aplikuesve dhe se ne te ardhmen nese paraqiten kërkesa te tilla do te trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Janë dërguar në NJPMNP procesverbalet e Bordit të drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit në kopje fizike të nenshkruara.Procesverbalet e dërguara sipas kërkesës së analistit të Njesisë janë nga mbledhjet e mbajtura prej janarit deri në gushtë 2013.
- Kemi pranuar Opinionin e Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit përkitazi me pjesëmarrjen e nënpunësve publik ne zgjedhjet lokale 2013.

3.2 PERSONELI – KORRIK– SHTATOR 2013

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
korrik	287		0	0	06.06.vdekje e punt.A.O 19.06.vdekje e punt.I.S
gusht	289	2	2	0	1 punt.pushim të lehonisë 30.08.2013-2 punt.te larguar
shtator	291	4	0	0	1.punt. pushim pa pagesë

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: SHTATOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	236	36	6	13	291
Numri i Punëtorëve në %	81.1	12.4	2.1	4.5	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	32	11.00	
MESHKUJ:	259	89.00	
TOTAL	291		

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: SHTATOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A						
KUALIFIKIMI						
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	27	17	187	55	5	291
Kualifikimi në %	9.28	5.84	64.26	18.90	1.72	

3.3 Raport rreth Punës së Zyrës Ligjore

RAPORTI PËR GJYKATA KOMUNALE KORRIK – SHTATOR 2013

Periudha	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për Ekzekutim	Seancat nënshkrimtare	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Kallëzime	Deklarata në Prokurori	Parashtrësia	Parashtrësia në Prokurori	ANKESA në Gjykatën e	Përgjigje në Ankesa	REVIZION	Përgjigje në Revizion	TOTALI	Totali i Lëndëve të ardhura nga
Korrik	/	/	6	3	4	3	/	/	/	/	1	2	/	/	19	20
Gusht	/	/	2	/	/	/	/	/	/	/	2	1	1	1	7	10
Shtator	/	/	1	2	/	2	/	/	/	1	1	1	/	/	8	8
Totali	0	0	9	5	4	5	0	0	0	1	4	4	1	1	34	38

ANKESA NË GJYKATËN E APELIT KUNDËR KRU-së

Me datë 15.07.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore e Prizrenit ANKESA nga i Padituri BAJRAM BALLABANI, ku i njëjti ka parashtruar Ankesë në Gj. e APELIT në Prishtinë kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 342/05, të datës 25.03.2013 me të cilin AKTGJYKIM Gj. Themelore në Prizren ka marrë vendim që pjesërisht (268.31 €) - Debitori ta kryej detyrimin ndaj Kompanisë sonë.

Me datë 01.08.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 873/11, datë 07.05.2012, nga Debitori SHAIPI RAMADANI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN C.nr. 873/11, datë, 07.05.2012, sipas të cilit Gj. Themelore (ish Komunale) ka marrë Vendim që Debitori ta paguaj shumën prej 284.40 €.

Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 687/11, datë 21.08.2012, nga Debitori SHASIVAR GASHI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë ku Gjykata Themelore konsideron se PADIA E PADITËSIT është tërhequr, andaj i njëjti kërkon nga Gjykata e Apelit në Prishtinë që lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me datë 26.09.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 603/09, datë 29.07.2013, nga Paditësi ILIAZ BULECI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Kërkesëpadinë e tij për kompensimin e të ardhurave personale.

PËRGJIGJE NË ANKESA

Me date 01.07.2013, është dërguar përmes Postës (PTK-së) PËRGJIGJE NË ANKESË në Gjykatën Themelore të Prizrenit kundër ankesës së parashtruar nga Konsumatori MUSTAFA KAZAZ kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 828/11, të datës 13.02.2013, i cili ka kërkuar fshirjen e borxhit si dhe vendosjen e masave të sigurisë. (Kjo lëndë ka ardhur në muajin QERSHOR andaj kemi më shumë PËRGJIGJE NË ANKESA SE SA ANKESA TË ARDHURA).

Me date 19.07.2013, është dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË në Gjykatën Themelore të Prizrenit për GJYKATËN E APELIT NË Prishtinë, kundër ankesës së parashtruar nga Konsumatori BAJRAM BALLABANI kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 342/05, të datës 25.03.2013, lidhur me pagesën e borxhit ndaj Kompanisë sonë në lartësi prej 268.31 €.

Me date 09.08.2013, e kemi përgatitur dhe kemi dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË NDAJ KONSUMATORIT SHAIPI RAMADANI, i cili e ka kundërshtuar AKTGJYKIMIN C.nr. 873/11, datë 07.05.2012 i cili e detyron debitorin për pagesën e borxhit ndaj Kompanisë sonë në lartësinë prej 251.68 €

Me datë 03.09.2013, është bërë PËRGJIGJE NË ANKESË ndaj Paditësit SHASIVAR GASHI, lidhur me AKTGJYKIMIN C.nr. 687/11, të datës 21.08.2012 i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë ku Gjykata Themelore konsideron se PADIA E PADITËSIT është tërhequr, andaj i njëjti kërkon nga Gjykata e Apelit në Prishtinë që lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje

REVIZION

Me date 26.08.2013, nga Gjykata Themelore ka ardhur REVIZION nga ish punonjësi AHMET RAMA i cili i është drejtuar GJYKATËS SUPREME lidhur me AKTGJYKIMIN AC.nr. 1355/2013, datë 01.07.2013, lidhur me AKTGJYKIMIN e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 774/11, datë 19.02.2013, respektivisht pika V e dispozitivit.

PËRGJIGJE NË REVIZION

Me 29.08.2013 është dërguar në Gjykatën Themelore PËRGJIGJE NË REVIZION për lëndën e AHMET RAMA, ku postieri i kompanisë përmes telefonit ka lajmëruar se nuk ka nevojë sipas zyrtarëve të Gjykatës që të paguhet taksa Gjyqësore.

VENDIMET E GJYKATËS THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË

AKTGJYKIMI C.nr. 257/11, datë 03.06.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren E KA SHPALLUR FAJTORË DHE E KA DËNUAR ME KUSHT në afat prej 6 muajve z. IZET ISLAMI, F. Shkozë, pasi që i njëjti e ka dëmtuar rrjetin e ujësjellësit të Kompanisë sonë.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 767/05, datë 06.06.2013, me të cilin pjesërisht aprovet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga Debitori FLORIM GËRMIZAJ, Rr. Edit Durham, Lamela II, nr.25, në Prizren, në lartësinë e 174.89 €, (shuma e kërkuar 335.33 €), si dhe shpenzimet procedurale, 15 ditë nga plotë-fuqishmëria e Aktgjykimit.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 354/05, datë 28.06.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga debitori SEFER BEKTESHI, Rr. Xheladin Hana, nr. 99, në Prizren, në lartësinë e 351.53 €, (shuma e kërkuar 451.53 €. I Padituri i ka paguar me datë 20.12.2004, në N.P. "Cvileni 100 €, andaj sipas Gjykatës Debitori i ka edhe 351.53 € pa paguar), si dhe shpenzimet procedurale (- 40 € -, pra në TOTAL Kompanisë duhet paguar 491.53 €) , 15 ditë nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 873/11, datë 07.05.2012, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga Paditësi dhe Debitori SHAIPI RAMADANI, Lagja Ortakoll., Lamela III/II, nr. 24, në Prizren, në lartësinë e 251.68 €, kurëse pjesa e borxhit prej 49.83 €, nuk është aprovuar për pagesë nga ana e Gjykatës Themelore.

AKTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 603/13, datë 17.07.2013, me të cilin konstatohet se padia e paditësit HAMZA HALABAK, nga Prizreni, ËSHTË TËRHEQUR.Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ANKESË.

AKTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 687/11, datë 30.07.2013, ku pasi që Paditësi nuk i ka paguar taksat gjyqësore Gjykata Themelore në Prizren me AKTVENDIM ka vendosur se Padia e Paditësit SHASIVAR GASHI, Rr. Selajdin Berisha, nr. 36/b nga Prizreni, konsiderohet se është tërhequr.

PROCESVERBALI nga seanca kryesore lidhur me lëndën C.nr. 633/10, ku kemi arritur MARRËVESHJE GJYQËSORE me Debitorin RUFAT SMAILI rreth pagesës me rata të borxhit që e ka ndaj Kompanisë sonë.

AKTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 745/05, datë 01.07.2013, ku pasi që Paditësi nuk ka marrë pjesë në seancë gjyqësore edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, Gjykata Themelore në Prizren me AKTVENDIM ka vendosur që Padia e Paditësit VAHID KABASHI, Rr. Selajdin Braha, nr. 36/b, nga Prizreni, për kompensim të dëmit tani në lartësi prej 33.083.00 €, konsiderohet se është tërhequr.

Sot është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 335/2006, datë 27.05.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkespadia e Kompanisë lidhur me borxhin e kërkuar në lartësi prej 640.88 €, e që me këtë Aktgjykim Gjykata Themelore e aprovon vetëm pjesën prej 214.74 €, nga Debitori JUSUF KUPAJ.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 603/09, datë 29.07.2013, me të cilin REFUZOHET SI E PABAZUAR Kërkesëpadia e Paditësit ILAZ BULECI nga Prizreni me të cilën ka kërkuar kompensim të të ardhurave personale në lartësi prej 15.450.55 €.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 782/05, datë 06.08.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga Debitori ISA OSMANKAJ, Rr. Josip Relja, nr. 8, në Prizren, në lartësinë e kërkuar prej 209.16 €, kurëse pjesa e miratuar nga Gjykata është 36.43 €, pra shuma prej 172.73 € nuk është aprovuar për pagesë nga ana e Gjykatës Themelore nën arsyetimin se kjo pjesë e borxhit është parashkuar.

KOMENT: Jemi në rrugë të mbarë për ta shmangur rrezikun i cili na kanosej lidhur me Lëndën C. nr. 603/09, datë 29.07.2013, ku me Aktgjykim Gjykata Themelore e REFUZON SI TË PABAZUAR Kërkesëpadinë e Paditësit z. ILAZ BULECI, Rr. Shote Galica, nr. 2, nga Prizreni, i cili me kërkesëpadinë e tij ka kërkuar kthim në vendin e punës dhe njëkohësisht

edhe kompensim të të ardhurave personale në lartësi prej 16.578.45 €, dhe kjo e përlloritur deri me datën 31.05.2013. Sikur lënda në fjalë të fitohet nga Paditësi Z. Ilijaz Buleci, në këtë çështje kanë qenë të përfshirë edhe 2 (dy) ndërhyrës tjerë, z. Sabit Bytyqi dhe z. Sylejman Gashi të cilët e kanë pasur kërkesën e njëjtë dhe sikur Gjykata Themelore të vendoste kundër Kompanisë sonë atëherë dëmshpërblimi nga kërkesëpatria e Paditësve do të arrinte trefishin e shumës së kërkuar nga Paditësi Ilijaz Buleci, pra shuma e kërkuar për dëmshpërblim do të ishte në lartësinë e 49.735.35 €, dhe atë vetëm deri më datë 31.05.2013.

Gjithashtu jemi në rrugë të mbarë që të lirohemi edhe nga një Padi tjetër e ngritur ndaj nesh kerkesa e padis kap vleren prej 33.083.00 €, në Gjykatën Themelore Paditësi z. Vahid Kabashi duke e parë se mbrojtja është pajisur me prova të pakontestueshme dhe të pakundërshtueshme, nuk ka ardhur në seancën e fundit nga se ka qenë i vetëdijshëm se do të humbë betejën, andaj nuk e ka parë të udhës që të prezantoj në seancë Gjyqësore e ku për pasojë gjykata Themelore bazuar në dispozitat pozitive ligjore ka marrë vendim me të cilin konstatohet se PADIA NË KËTË ÇËSHTJE JURIDIKE ËSHTË TËRHHJEKUR. Neve na mbetet që për këtë lëndë ta marrim edhe plotfuqishmërinë e Vendimit të Gjykatës Themelore.

VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË

Gjykata Themelore në Prizren AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 266/13, datë 22.07.2013, me të cilin HUDHET AKTAKUZA e PSH (Prokurorit Shtetëror) –Departamenti për krime të rënda në Prizren, PP.nr. 277/12, të datës 19.06.2013, me çka edhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit GËZIM DODA.

Gjykata Themelore AKTVENDIM lidhur me URDHËRESËN E GJYKATËS THEMELORE ndaj Pro Credit Bankës për bllokimin e xhirollogarisë së Kompanisë lidhur me PËRMBARIMIN ndaj z. Njazi Ademaj.

VENDIMET NGA GJYKATA E APELIT NË FAVOR TË KOMPANISË

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën AC.nr. 1355/13, datë 01.07.2013, lidhur me AKTGJYKIMIN C. nr. 774/11, datë 19.02.2013, me të cilin në pikën V të këtij Aktgjykimi refuzohet si e pabazuar kërkesa e Paditësit AHMET RAMA për kthim në vendin e tij të punës, Vendim të cilin e konfirmon edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë. I njëjti ka parashtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE

Nga Gj. Themelore në Prizren – ka ardhur AKTVENDIM C.nr. 872/05, datë 24.06.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren njoftohemi se është NDËRPRERË procedura në këtë çështje juridike kontestimore - BORXH- (537.46 €) pasi që Debitori HILMI ELSHANI ka vdekur.

Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 783/05, datë 09.07.2013, me të cilin NDËRPRITET çështja juridike kontestimore për shkak të vdekjes së të Paditurit për borxh në lartësinë 409.53 €, MAHMUT FISHEKQI, Rr. Kosovës, nr. 25/A, në Prizren.

KOMENT:Për rastet kur familjarët e të ndjerit e njoftojnë Gjykatën se ky person ka vdekur, atëherë Gjykata merr Vendim me të cilin procedura Gjyqësore në këtë çështje ndërpritet deri në inicimin e procedurës për trashëgimi të të ndjerit.

LËNDËT QË JANË NË PROCEDURË DHE QË KËRCËNOJNË KOMPANINË

Lënda C.nr. 1214/12, datë 05.03.2013, KONTEST PUNE nga z. Remzi Hoxha, F.Zhur, KK Prizren, Padi për kthim në vendin e punës dhe dëmshpërblimi për kohën sa nuk ka punuar.

Lënda C.nr. 214/10, datë 23.05.2012, KONTEST PUNE nga z. Hanefi Muharremi, Rr. Kasem Begu, nr. 17, nga Prizreni, Padi për kthim në vendin e punës dhe dëmshpërblimi për kohën sa nuk ka punuar.

Lënda C.nr. 116/03, Padi nga z. Xhezair Bajrami nga Dragashi, për KOMPENSIM DËMI në vlerë prej 21.447.32 €, shumë kjo e përlogaritur për periudhën kohore vetëm deri më datë 14.06.2012, për periudhën kohore shtesë ka për tu bërë përlogaritje e re, si dhe shpenzimet procedurale.

Lënda C.nr. 262/10, Padi e ngritur nga z. Shaban Kurtaj, F.Zhur, KK Prizren, për vërtetimin e pronësisë sipas mbajtjes dhe pranimit, lëndë kjo në të cilën ne jemi thirrur në mungesën e legjitimacionit pasiv pasi që bëhet fjalë sipas të gjitha gjasave për pronë të KK Prizren apo Qeverisë së Republikës së Kosovës, mirëpo pasi që ende nuk ka përfunduar së gjykuari kjo lëndë ne jemi në pritje të Vendimit Gjyqësorë lidhur me lëndën në fjalë.

PROPOZIM PËR EKZEKUTIM SIPAS AKTGJYKIMEVE

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit ndaj Sait Skenderi;

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Dashnor Gërmizaj;

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Neshat Poniku;

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Haki Shehu;

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Irfan Bojaxhiu, dhe,

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Zejnel Braha.

PROPOZIM PËR LEJIMIN EKZEKUTIMIT PËR BORXH

Me datë 30.08.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim për borxh ndaj Shefqet Hiseni;

Me datë 30.08.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim për borxh ndaj Bajram Gashi, si dhe,

Me datë 03.09.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim për borxh ndaj Xhavit Ukaj.

LËNDËT E PROCEDUARA NË GJYKATËN PËR KUNDËRVAJTËJE

Masat e ndërmarra nga Gjykata për Kundërvajtje në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Korrik – Shtator 2013 Gjatë periudhës kohore Korrik – Shtator 2013, nga Gjykata për Kundërvajtje e Prizrenit janë shqyrtuar gjithsej 20 (njëzetë) Kërkesa për kyqje ilegale.

Për 1 (një) Kërkesa është shqiptuar masa e qortimit;

Për 0 (0) Nuk ka pasur të shqiptuar masa të pezullimit;

Për 19 (nëntëmbëdhjetë) Kërkesa është shqiptuar masa e dënimit në të holla, ku shuma totale e dënimeve e kap shifrën e 1410 (njëmijë e katër qindtë) Euro.

Tremujori i III-të	Masa e qortimit	Hidhet poshtë	Masa e pezullimit	Masa e dënimit në Euro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënimeve në €
Korrik	1	/	/	19	20	1410 €
Gusht	/	/	/	/	/	/
Shtator	/	/	/	/	/	/
Totali	1	/	/	19	20	1410 €

Gjatë këtij tremujori janë shqyrtuar edhe Ankesat e konsumatorëve të cilat në total janë 20 (njëzetë) Ankesa të shqyrtuara dhe për të gjitha këto lëndë janë lëshuar Vendime.

Paraqitja tabelare e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve

MUAJI	NR. I VENDIMEVE TË LËSHUARA
KORRIK	/
GUSHT	52
SHTATOR	57
TOTAL	109

3.4 Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për korrik- shtator 2013

Gjatë kësaj periudhe tremujore, puna e Asistentëve të IT pranë Kompanisë kryesisht identifikohet me këto aktivitete dhe veprimtari:

1.Përshkrimi hyrës;

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezentohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

2.Raporti

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal te rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

- Nderhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 19 herë.

- Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 17 herë.

- Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 7 herë.

- Ndërhyrje në njesitë (Shatërvan, Depo, Koagolatorë) : 11 herë.

- Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 132 herë.

- Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.

- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

- Asistencë teknike për funksionimin normal te rrjetit telefonik lokal dhe fiks.

- Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë

- Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.

- Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.

- Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

- Kemi përkrahur vendosjen e rrjetit të IPKO-s nëpër 5 pikat kyqe te kompanisë

- Kemi popositur, furnizuar dhe instaluar 16 GB RAM memorje te Serverit kryesor NAVISION

- Kemi shtuar 4 GB RAM ArcGIS Serverit.

- Kam konfiguruar rrjetin e postes me ate te IPKO per funksionimin optimal të proceseve te kompanisë.

3.Komentet dhe vërejtjet,

- Mikroserveret e vendosur nëpër njësi janë duke u përdorur si backup serverë.

- Racku i sjelle nga USAID e qe ka kushtuar 1000 Euro nuk eshte ne shfrytezim.
- Para një muaji na është prishë centrala e telefonisë fikse (lokale) për shkaqe të luhatjes së tensionit elektrik.
- Zgjidhja e problemeve me kontraktorin për furnizimi me paisje të IT. Kemi shumë vonesa në marrjen e paisjeve që po i porosisim.
- Ka mbetur Depo (Mulliri) pa e kyq në database për shkak të mungesës së paisjes VPN Router.
- Kabineti ekzistues kompjuterik nuk është në gjendje optimale sa l përket sistemimit kabllovik, koneksioneve, ventilimit, sigurisë, burimit energjetik e të ngjajshme.

4.Propozimet – kërkesat

- Mikroserveret e vendosur nëpër njësi të konfigurohen për funksion në bazë.
- Njohuritë e mija të IT-së rreth konfigurimit të centralave telefonike janë të mangëta. Kisha dashtë me diskutu mundësinë financimit të mbajtjes së një trajnimi tek kompanitë përkatëse rreth konfigurimit dhe mirëmbajtjes së centralave të telefonisë p.sh siq është kompania Adria Telecommunications.
- Jam përgatitë për shumë certifikime tjera të Cisco Systems dhe Microsoft Certifications, mirëpo për shkak të obligimeve tjera nuk po mund t'i mbuloj dhe natyrisht këto kanë një kosto të parapagimit prandaj në këtë drejtim shpresoj në mbështetje të Kompanisë për pagimin e këtyre certifikimeve. Një certifikim Microsoft, kushton 80 \$ mirëpo një Cisco 260 \$.
- Meqenëse depoja nuk është ende e kyqur në rrjetin e aplikacionit NAVISION kërkoj blerjen e një VPN Routerit për instalim në Depo.
- Instalimi i mëparshëm i rrjetit kompjuterik i hasur në objekt ka vendosur kabinetet kompjuterike (RACK) në koridor i cili për shkaqe sigurie dhe të tjera nuk preferohet prandaj propozoj dhe kërkoj që të sigurohet një kthinë e veçantë brenda objektit me kushte të parapara ventilimi e sigurie që kabineti i tillë të vendoset në te. Me këtë aksion do të mënjanohej edhe vërejtja rreth gjendjes dhe sistemimit të kabineteve kompjuterike.

IV. AKTIVITETI I SHËRBIMIT FINANCIAR

4.1 AKTIVITETET - KORRIK-SHTATOR-2013

- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje,
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet;
- Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet
- Lisitimi i borxheve dhe pagesat e furnitorëve
- Prgatitja e raporteve mujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj
- Takime me kryeshefin lidhur me performancën e muji të kaluar të kompanisë.

- Takim me manxhmentin e kompanisë lidhur me përgatitjen e raporteve për plan biznes 2014 – 2016
- Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;
- Takim me menaxhmentin e kompanisë, me shërbimet përkatëse;
- Aktiviteti më kryesor është ai i rritjes së performancës së kompanisë, në angazhimin e gjithë neve, në uljen e shpenzimeve, aty ku ato janë të pa nevojshme. Inkasimi në nivel të kompanisë ka qenë pak më i lartë se sa muajin e kalur dhe angazhimi jonë do të vazhdojë në rritje të tij.

Arsyeshmëria e shpenzimeve

Shpenzimet operative të muajit shtator kanë qenë më të larta se ato të muajit gusht, ndërsa norma e mbulueshmërisë në këtë muaj ka qenë më e ultë, por mbi 1

Do të japim disa nga arsytet në pozicione të ndryshme, që kanë lëvizur shpenzimet nga muaji paraprak me muajin gusht.

- Në pozicionin e pagave kemi një të tyre, sepse kemi rritje të stafit, gjithashtu edhe pagesen e bonuseve për anëtarët e bordit.
- Pozicioni i energjisë elektrike ka një rënje të vogël të shpenzimeve. Por që kjo, nuk ka ndikuar shumë në shpenzimet totale.
- Te pozicioni i derivative kemi një vazhdimsi të këtyre shpenzimeve, ngase operimi jonë veq është duke u zgjeruar në shumë zona.
- Shpenzimet, te pozicioni i mirëmbajtjes janë ngritur, kemi pasur intervenime në rrjet, kemi bërë edhe ndërrimin e gomave të makinerisë së rëndë, etj.
- Në tërësi shpenzimet kanë qenë më të larta, por dhe norma e mbulueshmërisë nuk ka qenë keq.

4.2 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE KORRIK-SHTATOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM2-2013	TM3-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	3,985,192	4,480,398	495,206	12.43
Faturimi m3	1,562,090	1,777,160	215,070	13.77
Faturimi nga uji €	837,089.70 €	935,204.21 €	98,114.51 €	11.72
Faturimi- te tjera €	39,932.47 €	14,201.18 €	- 25,731.29 €	-64.44
Faturimi Total €	877,022.17 €	949,405.39 €	72,383.22 €	8.25
Inkasimi nga uji €	558,459.53 €	659,847.82 €	101,388.29 €	18.15
Inkasimi - te tjera €	20,526.05 €	27,407.17 €	6,881.12 €	33.52
Inkasimi Total €	578,985.58 €	687,254.99 €	108,269.41 €	18.70
Nr. i Konsumatorëve	29025	29316	291	1.00
% e inkasimit	66.71	70.56	3.84	5.76
Shpenzimet	517,301.45 €	592,380.39 €	75,078.94 €	14.51
Uji I pafaturuar në m3	2,423,102	2,703,238	280,136	11.56
Uji I pafaturuar ne %	60.80	60.33	-0.47	-0.77
Mbulimi operativ	1.12	1.16	0.04	3.66

Prodhimi i ujit ne njesin punuse ne Prizren gjate TM3 ka pasur rritje te prodhimit te ujit me nje ndryshim prej 495,206 m³ ose 12.43%.

Nryshimi i sasis se ujit te prodhuar per kete periudhe lidhet edhe me rritjen e numrit te konsumatorve.

- Në fund të TM3 në Njësien e Prizrenit janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 29.316 fatura, prej tyre: 25.303 amvisëri , 3611 biznese dhe 402 institucione.Në tremujorin e tretë në krahasim me tremujorin paraprak kemi 291 fatura të lëshuara me tepër.Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyqje ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës dhe rezultat i pëlqimeve për kyqje në shërbim të ujësjellsit dhe kanalizimit.

- Gjatë muajit TM3 janë faturuar 1.777.160m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.460.969 m³, biznese: 122.677 m³ dhe institucione 193.514 m³ ujë .Nëse e krahasojm me tremujorin paraprak kemi një ne faturim më të madh prej 215.070 m³.Rritja e sasia së ujit të faturuar vjen si rezultat i rritjes së konsumit te të tri kategorit e konsumatorëve, kjo rritje vjen edhe si rezultat i përmirsimit të furnizimit me ujë. Arsyetim:
 - Rritja e faturimit për TM3 është rezultat i rritjes së konsumit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake si dhe shtimit të numrit të konsumatorëve nga muaji në muaj .

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE KORRIK-SHTATOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM2-2013	TM3-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	466,689	481,206	14,517	3.11
Faturimi m3	200,193	238,473	38,280	19.12
Faturimi nga uji €	110,249.81 €	123,887.81 €	13,638.00 €	12.37
Faturimi- te tjera €	9,507.69 €	8,834.11 €	- 673.58 €	-7.08
Faturimi Total €	119,757.50 €	132,721.92 €	12,964.42 €	10.83
Inkasimi nga uji €	48,746.40 €	58,736.74 €	9,990.34 €	20.49
Inkasimi - te tjera €	9,531.10 €	8,669.66 €	- 861.44 €	-9.04
Inkasimi Total €	58,277.50 €	67,406.40 €	9,128.90 €	15.66
Nr. i Konsumatorëve	4271	4605	334	7.82
% e inkasimit	44.21	47.41	3.20	7.23
Shpenzimet	69,094.03 €	80,672.36 €	11,578.33 €	16.76
Uji I pafaturuar në m3	266,496	242,733	(23,763)	-8.92
Uji I pafaturuar ne %	57.10	50.44	-6.66	-11.66
Mbulimi operativ	0.84	0.84	-0.01	-0.94

Prodhimi i ujit gjate TM3 ne njesin punuse ne Suhareke ka qene ne rritje te vogel prej 14,514m³ ne krahasim nga TM2 ose 3.11% si rezultat i rritjes te numrit te konsumatorve si per shkak te temperaturave te larta. Kjo rritje e prodhimit te ujit paraqitet me aktivizimin e pompave ne burime.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE KORRIK-SHTATOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM2-2013	TM3-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	116,312	131,812	15,500	13.33
Faturimi m3	58,238	65,218	6,980	11.99
Faturimi nga uji €	38,384.62 €	40,741.72 €	2,357.10 €	6.14
Faturimi- te tjera €	1,302.88 €	610.00 €	- 692.88 €	-53.18
Faturimi Total €	39,687.50 €	41,351.72 €	1,664.22 €	4.19
Inkasimi nga uji €	29,872.23 €	30,883.63 €	1,011.40 €	3.39
Inkasimi - te tjera €	1,302.90 €	588.00 €	- 714.90 €	-54.87
Inkasimi Total €	31,175.13 €	31,471.63 €	296.50 €	0.95
Nr. i Konsumatorëve	1083	1101	18	1.66
% e inkasimit	77.82	75.80	-2.02	-2.60
Shpenzimet	25,674.02 €	27,306.23 €	1,632.21 €	6.36
Uji I pafaturuar në m3	58,074	66,594	8,520	14.67
Uji I pafaturuar ne %	49.93	50.52	0.59	1.19
Mbulimi operativ	1.21	1.15	-0.06	-5.08

Ne njesin e Dragashit prodhimi i ujit ne kete tremujor eshte ne rritje te dukshem per shkak se gjate kohes se veres kemi numer te madhe te konsumatorve te cilet vijne per ti kaluar pushimet verore dhe kjo rritje per TM3 ka nje ndryshim prej 15,500 m³ nga tremujori papaprak ose nje rritje prej 13.33%.

- Njësia Operative në Dragash në tremujorin e tretë ka pasur mbulim operativ të kënaqshëm.
- Në uljen e mbulimit Operativ ka ndikuar shtimi i të ardhurave personale për dy punëtor që janë pranuar, njëri nga të cilët që nga pranimi asnjë ditë nuk ka qenë në njësinë tonë ndërsa paga i është dhënë nga mjetet e grumbulluara të njësisë.
- Në uljen e koficientit të mbulimit operativ nga tremujori i dytë në tremujorin e tretë ka ndikuar edhe pagesa me vonesë e mjeteve të lëshuara nga fabrika Remateks të cilat nuk kanë mundur të hyjnë në realizim në tremujorin e tretë.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE KORRIK-SHTATOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - MALISHEVË

MUAJI	TM2-2013	TM3-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	293,212	362,556	69,344	23.65
Faturimi m3	125,168	146,039	20,871	16.67
Faturimi nga uji €	75,192.73 €	81,616.92 €	6,424.19 €	8.54
Faturimi- te tjera €	2,994.19 €	1,607.61 €	- 1,386.58 €	-46.31
Faturimi Total €	78,186.92 €	83,224.53 €	5,037.61 €	6.44
Inkasimi nga uji €	49,620.79 €	62,310.28 €	12,689.49 €	25.57
Inkasimi - te tjera €	3,201.93 €	2,706.38 €	- 495.55 €	-15.48
Inkasimi Total €	52,822.72 €	65,016.66 €	12,193.94 €	23.08
Nr. i Konsumatorëve	3410	3467	57	1.67
% e inkasimit	65.99	76.34	10.35	15.69
Shpenzimet	54,564.10 €	59,908.68 €	5,344.58 €	9.80
Uji I pafaturuar në m3	168,044	216,517	48,473	28.85
Uji I pafaturuar ne %	57.31	59.72	2.41	4.20
Mbulimi operativ	0.97	1.09	0.12	12.10

Ne njesin e Malisheves kemi rritje te prodhimit prej 69,344 m³ ose 23.65% nga tremujori paraprak per arsye se kemi edhe rritje te prodhimit sepse gjate kesaj periudhe vere ndihet nevoja per te shpenzuar me teper uji te prodhuar.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE KORRIK-SHTATOR 2013

• HIDROREGJIONI JUGOR - TM2- TM3-2013

MUAJI	TM2-2013	TM3-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	4,861,405	5,455,972	594,567	12.23
<i>Prodhimi - l/sec</i>	618	694	75.6	12.23
<i>Faturimi m3</i>	1,945,689	2,226,890	281,201	14.45
<i>Faturimi l/sec</i>	247	283	36	14.45
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,060,916.86 €	1,181,450.66 €	120,533.80 €	11.36
<i>Faturimi- te tjera €</i>	53,737.23 €	25,252.90 €	- 28,484.33 €	(53.01)
<i>Faturimi Total €</i>	1,114,654.09 €	1,206,703.56 €	92,049.47 €	8.26
<i>Inkasimi nga uji €</i>	686,698.95 €	811,778.47 €	125,079.52 €	18.21
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	34,561.98 €	39,371.21 €	4,809.23 €	13.91
<i>Inkasimi Total €</i>	721,260.93 €	851,149.68 €	129,888.75 €	18.01
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	37789	38489	700	1.85
<i>% e inkasimit</i>	64.73	68.71	3.98	6.15
<i>Shpenzimet</i>	666,633.60 €	760,267.66 €	93,634.06 €	14.05
<i>Paqa bruto</i>	398,953.77 €	423,741.79 €	24,788.02 €	6.21
<i>Mirmba. dhe riparimet</i>	40,508.23 €	55,649.51 €	15,141.28 €	37.38
<i>Rryma elektrike</i>	133,345.99 €	164,857.60 €	31,511.61 €	23.63
<i>Shpenzi. e derivateve</i>	22,423.82 €	22,724.84 €	301.02 €	1.34
<i>Kemikalet</i>	1,587.92 €	5,422.26 €	3,834.34 €	241.47
<i>Shpenzi. tera operat.</i>	69,813.87 €	87,873.65 €	18,059.78 €	25.87
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,915,716	3,229,082	313,366	10.75
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	59.98	59.18	-0.79	(1.32)
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	370.84	410.70	39.86	10.75
<i>Mbulimi operativ</i>	1.08	1.12	0.04	3.47

Prodhimi i ujit gjate TM3 ne Hidroregjionin jugor ne nivelin regjional ka qene ne rritje prej 594,587m³ ne krahasim nga TM2 ose 12.23% si rrezultat i rritjes te numrit te konsumatorve si dhe per shkak te temperaturave te larta qe kane ndikuar per te rritur nevoja e konsumit me te madhe te ujit te pijes si dhe mundesia e ujitjes.

Kjo rritje e sasis se ujit te pijes eshte si rrezultat i burimeve te reja, shpimeve te puseve ne regjionin e Prizrenit.

Në fund të TM3 në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 38.489 fatura, prej tyre: 33.336 amvisëri , 4542 biznese dhe 611 institucione.Në tremujorin e tretë në krahasim me tremujorin paraprak kemi 700 fatura të lëshuara me tepër.Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyqje ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës dhe rezultat i pëlqimeve për kyqje në shërbim të ujësjellsit dhe kanalizimit.Gjatë këtij tremujori është marrë nën menaxhim edhe fshati Sallagrazhd në njësin e Suharekës.

Sipas njësisve kemi këtë rritje të konsumatorëve në krahasim me muajin paraprak :

Prizren: +291 , Suharekë: +334, Malishevë: + 57, Dragash: +18.

Gjatë muajit TM3 janë faturuar 2,226,891 m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.823.460m³, biznese: 156.337 m³ dhe institucione 247.094 m³ ujë.Nëse e krahasojm me tremujorin paraprak kemi një ne faturim më të madh prej 278.202 m³, ndërsa nëse krahasohet me TM2 të vitit paraprak kemi një rritje në faturim për 27.839 m³. Rritja e sasia së ujit të faturuar vjen si rezultat i rritjes së konsumit te të tri kategorit e konsumatorëve, kjo rritje vjen edhe si rezultat i përmirimit të furnizimit me ujë. Arsyetim:

Rritja e faturimit për TM3 është rezultat i rritjes së konsumit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake si dhe shtimit të numrit të konsumatorëve nga muaji në muaj .

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e tretë të 2013, në krahasim me tremujorin e dytë, kanë qenë më të larta, por edhe trendi i inkasimit dhe mbulueshmërisë operative ka qenë në rritje. Pra, indikacione në rritje të performancës së kompanisë. Më poshtë do t'i cekim disa nga arsyet dhe ndryshimet në disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve.

Së pari shpenzimet si total në këtë tre mujor janë më të larta, duke ditur se aktivitetet operative dhe investuese kanë qenë në rritje, gjë që ka ndikuar edhe në rritje të inkasimit në këtë tre mujor, gjithashtu edhe norma e mbulueshmërisë është në nivel me të kënaqshëm.

Në pozicionin e pagave, kemi një rritje të shpenzimeve të tyre, sepse në këtë tre mujor kemi pasur një shtim të punëtorëve me arsyen se aktivitetet operuese kanë qenë më të shumta dhe nga nevoja për investime te vazhdueshme.

Gjithashtu edhe në shpenzimet e energjisë elektrike kemi një rritje të vogël, sepse kemi shtuar burime të reja të ujit.

Te pozicioni i derivative nuk kemi ndonjë ndryshim, nëse e shikojmë si mesatare këtë tre mujor më atë paraprak, kemi një shpenzim të njejtë.

Ndërsa te mirëmbajtja, kemi ndryshim të shpenzimeve, pra një rritje të vogël të tyre, në krahasim me tre mujorin e kaluar. Me arsyetimin se me rritjen e zonave operuese ka ndikuar edhe në rritje të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Pra, investimet tona janë duke vazhduar në gjetjen e burimeve të ujit dhe ndërtimin e rezervuarve të rinjë të ujit, në mirëmbajtjen e rrjetit, etj.

V. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të ndërmarra të auditorit të brendshëm, për periudhën kohore korrik – shtator 2013.

Për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, detajisht është raportuar në takimet e komisionit të auditimit dhe ekzistojnë raporte të përgaditura me shkrim, mirëpo ky raport shkurtimisht paraqet një kronologji të aktiviteteve tremujore të ndërmarra.

Në pajtim me planin vjetor të paraparë, janë bërë auditime në disa subjekte audituese, sikurse në:

- departamentin e financave,
- departamentin teknik,
- shërbimin me konsumatorë dhe në
- Njësitë Punuese, atë të Suharekës, të Malishevës dhe të Dragashit.

Fusha e auditimit ka qenë:

- Menaxhimi i proceseve dhe aktiviteteve të zhvilluara në:
 - Njësinë Punuese në Suharekë,
 - Njësinë Punuese në Malishevë, dhe
 - Njësinë punuese në Dragash.
- Menaxhimi i procesit të riparimit dhe vendosjes së ujëmatësve,
- Menaxhimi i procesit të faturimit, inkasimit dhe kontrollës,
- Menaxhimii të hyrave të realizuara përmes arkës dhe portoarkave, si dhe
- Përmbledhja e realizimit të rekomandimeve të dhëna për periudhën janar – shtator 2013.

Pas përfundimit të auditimeve dhe testeve të nevojshme, në pajtim me procedurat punës së auditimit është bërë:

- përgatitja e draftraporteve për të gjitha auditimet e lartpërmendura,
- mbajtja e takimeve me subjektet e audituara dhe diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
- finalizimi i draftraporteve (përveq draft raportit të auditimeve të kryera në shërbimin me konsumatorë lidhur me menaxhimin e procesit të faturimit, inkasimit dhe kontrollës).
- gjithashtu është bërë një rekapitullim i të gjeturave, rekomandimeve dhe implementimit të tyre për periudhën kohore janar – shtator 2013.

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

